



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 142

26 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 663, datë 17.7.2013	Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016.....	6035
Vendim i KM nr. 670, datë 7.8.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të pasurisë së paluajtshme, me sipërfaqe 25 000 m ² , me nr. 1/190, në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë.....	6170
Vendim i KM nr. 699, datë 16.8.2013	Për miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure, ndërmjet “Albpetrol” sh.a. dhe “Phoenix Petroleum” sh.a., për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet e naftës Amonicë, Drashovicë e Pekisht-Murriz, si dhe vendburimet e gazit Panaja, Frakull, Povelçë, Divjakë, Ballaj-Kryevidh dhe Finiq-Krane.....	6171

VENDIM

Nr. 663, datë 17.7.2013

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT
TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT, 2013-2020 DHE
PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITET 2013-2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT 2013-2020

II. Lista e Shkurtimeve

AIM	Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes
AKKP	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave
AQKKP	Agjencia Qendrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
CARIN	Rrjeti i Zyrave për Rikuperimin e Aseteve Kriminale
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DKKOKR	Drejtoria Kunder Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
KKOTT	Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave
DRSHTRR	Drejtoria Rajonale e Shfrytëzimit të Transportit Rrugor
EJL	Evropa Juglindore
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
IKE	Komisioni European
ISSH	Instituti të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
KKBLKD	Komiteti Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës
KBLKPP	Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave
MIK	Manaxhimi i Integruar i Kufirit
MPCSSHB	Minsitria e Punës Çështjes Sociale
NJAT	Njësia Kombëtare Antitrafik
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MEMEX	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Kriminal
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
QVT	Qendrave të viktimave të trafikimit
QDMOS	Qendra e Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale
RKGJC	Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SELEC	Qendra e Zbatimit të Ligjit të Europës Juglindore
SIVET	Sistemi i Informacionit për Viktimat e Trafikimit
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
ZQRPP	Zyra Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

Metodologjia dhe procesi

Metodologjia bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me SKZHI 2013-2020, në harmonizimin sa më të mirë me ciklin e PBA-së dhe me strategjitë e tjera sektoriale e ndërsektoriale.

Zhvillimi i strategjisë ka kaluar nëpër një proces gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të fushës së përfshirë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit.

Strategjia bazohet mbi të dhënat statistikore të institucioneve, agjencive të zbatimit të ligjit dhe atyre të inteligjencës, raportet periodike të monitorimit të strategjisë në Sekretariatit Teknik, raportet vjetore të performancës të strukturave të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit, informacionet për çështje të caktuara dhe intervistat e bëra me drejtues të institucioneve. Ndërkohë, janë shfrytëzuar të dhëna edhe nga raporte të institucioneve e organizmave ndërkombëtare, vlerësimet kritike në Progres Raportet e KE-së për Shqipërinë. Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar kryesisht nga pikëpamja e rezultateve dhe ndikimeve të politikave, në funksion të paraqitjes të ecurisë realizimit të objektivave strategjike dhe indikatorëve të matshëm të performancës.

Procesi ka kaluar nëpër disa faza: Faza e parë (Shtator 2012); grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave lidhur me situatën e krimit të organizuar, arritjet, mosarritjet, sfidat (analiza SWOT), përcaktimi i Vizionit, synimeve, objektivave strategjike dhe atyre specifike dhe buxhetit. Në fillim të procesit për hartimin e Strategjisë u formuan; Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) dhe ekipet e punës së institucioneve, të cilëve u është dhënë mbështetja e plotë politike dhe institucionale. Identifikimi i prioriteteve dhe objektivave strategjike është bërë nëpërmjet konsultimit me institucionet e përfshira në këtë strategji, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës dhe shqyrtimit të tyre në takimet me Grupin Ndërmnistror të Punës.

Drafti i parë i dokumentit strategjik ka përfunduar në 25 Tetor 2012. Pas marrjes së komenteve nga DEBASKON, institucionet e përfshira në strategji, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës dhe reflektimin e tyre u përgatit drafti i dytë, në Nëntor 2012.

Ndërsa faza e tretë (Maj 2013), shënon përmbylljen e procesit me hartimin e dokumentit përfundimtar dhe hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë 2013-2016.



Hyrja

Dokumenti strategjik është hartuar në bazë të eksperiencave dhe mësimave të nxjerra nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit për vitet 2008-2013, PV për zbatimin e kësaj strategjie si dhe në përmbushje të objektivave madhore të Qeverisë për arritjen e standardeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë dhe të marrjes së Statusit të Vëndit Kandidat për në BE.

Angazhimet e ndërmarra në këtë kuadër dhe objektivat e përcaktuara në këtë dokument strategjik shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e KE-së për Shqipërinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

Strategjia ka si qëllim të konsolidojë përparimin e bërë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit të arritura deri në momentin e tanishëm si dhe të përcaktojë politikën, prioritetet strategjike në këtë fushë, objektivat e institucioneve shtetërore që marrin detyrime në të, të harmonizojë e ngrejë në një shkallë më të lartë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitutional të punës për arritjen e objektivave strategjike për vitet 2013-2020. Në të njëjtën kohë strategjia synon të zhvillojë metoda e teknika të reja ligjore, institucionale, operacionale dhe shkencore sipas standardeve të përafuara të policive të vendeve të BE-së për t'iu kundërvënë me sukses formave dhe metodave të krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit.

Duke qenë se krimi i organizuar dhe terrorizmi përbëjnë një kërcënim serioz afatgjatë për institucionet, shoqërinë, ekonominë dhe cilësinë e jetës në Shqipëri, kjo strategji synon të zvogëlojë kërcënimin dhe ndikimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit në mjedisin tonë shoqëror.

Në funksion të këtij synimi, krahas institucioneve të tjera, Ministria e Brendshme, merr përsipër të luajë një rol të rëndësishëm në koordinimin e veprimeve gjatë implementimit të planit të veprimit të kësaj strategjie si dhe strategjive të tjera sektoriale të luftës kundër gjithë formave të krimit të organizuar e terrorizmit.

Me implementimin e kësaj strategjie sipas afateve të përcaktuara në planveprimin përkatës, Shqipëria do të progresojë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, duke u paraqitur si një partnere e besueshme, me standarde të larta dhe për të qenë e denjë si anëtare e familjes së Bashkimit Europian.

Kapitulli 1. Analiza e Situatës

Situata e krimit të organizuar në Shqipëri gjatë viteve të fundit, paraqitet më pak shqetësuese dhe madje më e kontrolluar, krahasuar me periudhën para vitit 2007. Format kryesore të krimit të organizuar mbeten po ato që kanë qenë, por që në periudhën e fundit si rezultat i ndikimit të fuqishëm të globalizimit dalin në plan të parë format e krimit transnacional e rajonal të trafikimit të lëndëve narkotikëve, pastrimit të parave, krimit kibernetik, trafikimit të qenieve njerëzore, mjeteve motorike të vjedhura dhe trafikeve të tjera të paligjshme. Grupet e krimit të organizuar vazhdojnë të përfitojnë nga vendndodhja e Shqipërisë si një vend tranzit, e cila preket nga rrugët e trafikimit të heroinës nga Azia në Ballkan e drejt vendeve të Europës Perëndimore. Trafikantët e drogës, sipas raporteve ndërkombëtare, duket se po marrin një rol gjithnjë e më të madh në financimin dhe shpërndarjen e heroinës jashtë Shqipërisë, veçanërisht në Ballkanin verior dhe Europën Perëndimore¹. Pavarësisht nga ky realitet, Shqipëria ka zbatuar një sërë politikash dhe strategji të përshtatshme gjatë viteve të fundit, të cilat janë vlerësuar edhe nga raportet ndërkombëtare.

Kësisoj, në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, Shqipëria gjatë viteve 2008-2013 zbatoi një Strategji Ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit si dhe strategjitë e tjera të ndërthurura me të si: Strategjia Kombëtare Antidrogë 2004-2010; Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 si dhe Dokumenti Plotësues “Për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve-Viktima të Trafikut”; Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” dhe Dokumenti Plotësues “Plani i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit” 2011 – 2013; Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Luftës Kundër Korrupsionit për një Qeverisje Transparente 2008-2013; Dokumenti Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar” për periudhën 2009-2015; Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Mjeteve Motorike, Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2011 – 2015.

Rezultatet e arritura në vitet e fundit, tregojnë se **në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar**, si një nga prioritetet kryesore të përcaktuara në Opinionin e Komisionit Europian, janë bërë disa përparime². Është shënuar rritje e efikasitetit të strukturave shtetërore përgjegjëse si dhe është arritur një bashkëpunim i koordinuar më i mirë mes strukturave ligjzbatuese dhe përdorimit gjerësisht të metodave dhe teknikave moderne në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

¹ Raport i DASH, Mars 2013

² Progres Raporti i KE-së për Shqipërinë, Tetor 2012, f.59



Për këtë periudhë janë rritur kapacitetet administrative dhe profesionale të strukturave të hetimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nëpërmjet krijimit të strukturave të reja, hartimit të akteve të reja ligjore e nënligjore, trajnimit të 8805 specialistëve si dhe futjes së pajisjeve teknologjike moderne në funksion të aplikimit të teknikave speciale të hetimit. Në fushën e luftës kundër drogës, Shqipëria vazhdon të arrijë sukses me programin e saj për reduktimin e prodhimit e trafikimit të drogave, për garantimin e një kontrolli efektiv dhe sigurimin e territorit të saj. Gjatë viteve 2004-2010, ajo zbatoi një Strategji Kombëtare Antidrogë. Objektivi, që lidhet me reduktimin e ofertës dhe trafikimit të drogave të forta dhe zvogëlimin e sipërfaqeve për kultivimin e bimëve narkotike, është realizuar për këtë periudhë. Edhe raportet ndërkombëtare të vitit 2013 nënvizojnë se Shqipëria ka bërë përparim në luftën kundër drogës³.

Janë rritur kapacitetet e bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore në luftën kundër drogës. Është hartuar dhe miratuar VKM nr. 299 datë 14.04.2011 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës, Sekretarisë së këtij Komiteti dhe Zyrës së Sistemit Kombëtar të të dhënave për drogën", i cili do të garantojë një bashkëveprim më të mirë të institucioneve si dhe grumbullimin e analizimin e të dhënave lidhur me drogën në shkallë kombëtare. Është miratuar Strategjia Kombëtare Kundër Drogës, 2012 – 2016 me VKM nr. Nr.403, datë 20.06.2012. Aktualisht është në proces miratimi Plani i Veprimit për Zbatimin e kësaj Strategjie. Objektivi dhe politika për reduktimin e ofertës dhe trafikimin e drogave të forta për vitet 2007-2013 dhe zvogëlimin e sipërfaqeve për kultivimin e bimëve narkotike është realizuar. Numri i rasteve të goditjeve ndaj shitjes e trafikimit të narkotikeve në vitin 2012 është rritur me 144 % krahasuar me vitin 2007, ndërsa i bimëve të kultivuara dhe asgjësuar është ulur me 5, 3 herë krahasuar me të njëjtit vite (*Shih statistikat dhe grafikun, Shtojca nr.1*). Edhe sasia e kokainës së sekuestruar në Itali të tranzituar nga Shqipëria mbetet në nivelin 0 kg, gjë që flet për një rritje të performancës të strukturave të luftës kundër narkotikëve (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*).

Ka pasur qëndrueshmëri në realizimin e operacioneve me teknikat speciale hetimore si dhe goditjen e grupeve kriminale të trafikut e shpërndarjes së lëndëve narkotike. Parandalimi dhe Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike ka qenë e efektshme. Çdo vit, Ministria e Brendshme implementon një plan veprimi të veçantë për luftën kundër kultivimit të kanabisit, ku janë përfshirë pushteti lokal dhe institucionet e tjera shtetërore. Vitet e fundit (2007-2012) është rritur ndjeshëm numri i operacioneve me teknikat speciale të hetimit me 252 operacione, gjatë të cilave janë goditur 254 grupe kriminale të trafikut dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike. Krahasuar me vitin 2007, në vitin 2012 numri i operacioneve me teknikat speciale të hetimit është rritur 47 % më shumë. Forcimi i luftës kundër trafikimit të narkotikëve konfirmohet nga raporti më i fundit, i cili vlerëson "përpjekjet e vitit të kaluar (2013) për t'iu përgjigjur problemit me politika me agresive⁴. Mundësia që grupet kriminale

³ Raporti i DASH, Mars 2013

⁴ Po aty

të trafikimit të drogës të lëvizin lirshëm në territorin shqiptar është reduktuar dhe një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të tyre kanë dalë para drejtësisë.

Për sa i përket **reduktimit të trafikeve të tjera të paligjshme dhe sidomos** të trafikimit të qenieve njerëzore, pavarësisht nga luhajtjet e vogla të koeficienteve të indikatorëve për disa vite, objektivi strategjik dhe politika në reduktimin e trafikeve të paligjshme për periudhën 2007-2012 është arritur. Kështu, në vitin 2012 rezulton një rritje e identifikimit dhe hetimit të veprave penale në fushën e luftës kundër trafikeve të paligjshme në masën 13,4%, krahasuar me vitin 2011 (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*). Është shënuar rritje në goditjen kundër grupeve të organizuara të trafikeve të qenieve njerëzore nëpërmjet kryerjes së 150 operacioneve policore (2007-2012) (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*). Ka një rritje të operacioneve ndërkombëtare në fushën e luftës kundër trafikeve të paligjshme gjatë vitit 2012 (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*).

Janë rritur **kapacitetet e të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave**. Duke filluar nga viti 2010 është punuar për rritjen e kapaciteteve të strukturave kundër trafikeve të paligjshme me 18 funksione të reja, kryesisht në drejtim të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke e rritur 20, 4% numrin e punonjësve të strukturave të policisë antitrafik. Në Institucionin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në vitin 2010, është ngritur një seksion i veçantë për hetimin e çështjeve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Në vitin 2011 është dyfishuar numri i koordinatorëve pranë Njësisë Antitrafik në Ministrinë e Brendshme. Është përmirësuar koordinimi i punës midis strukturave të zbatimit të ligjit dhe agjencive të tjera partnere siç janë qendrat dhe OJF-të e përfshira në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Gjatë vitit 2008 u unifikuua numri i viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit të raportuara nga institucionet shtetërore dhe ato jo shtetërore. Është bërë riprogramimi i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit, me një bazë më të plotë dhe të përditësuar të grumbullimit dhe analizimit të informacionit që prej identifikimit fillestar të një viktime/viktime të mundshme të trafikimit e deri në riintegrimin e plotë të saj. Aktualisht, në programin e ri të njohur si "Sistemi i Informacionit për Viktimat e Trafikimit" (SIVET), vazhdon hedhja e të dhënave nga përdoruesit nën kujdesin e Njësisë Antitrafik, e cila monitoron përdorimin e sistemit dhe përdor të dhënat e nxjerra prej tij.

Në muajin Qershor 2012, u miratua Marrëveshja e Re e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave, duke rritur numrin e aktorëve të përfshirë në marrëveshje dhe duke siguruar zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit edhe nga organizata të shoqërisë civile, palë në MKR. Në sajë bashkëpunimit efektiv ndërmjet Njësisë Antitrafik, ISSH, MSH, QVT dhe MPCSSHB, u hartua dhe u miratua VKM nr. 395, datë 20.6.2012 "Për Trajtimin e Viktimave të Trafikimit dhe Përfitimin e Shërbimeve Shëndetësore nga kjo Kategori", sipas të cilit viktimat e trafikimit në Shqipëri përfitojnë kujdes shëndetësor falas.



Katër qendrat (përfshirë edhe QVT), vit pas viti kanë rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara për viktimat e trafikimit. Në vitin 2011 u arrit të sigurohet financimi nga buxheti i shtetit i disa prej shpenzimeve të qendrave që japin shërbime për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

Është zbatuar një plan operacional kundër lypjes dhe shfrytëzuesve të fëmijëve, i cili që prej muajit dhjetor 2009 ka reduktuar ndjeshëm rastet e shfrytëzimit të fëmijëve në rrugë. MB në bashkëpunim me MASH, MPCSSH dhe disa OJF kanë zhvilluar një fushatë mbarëkombëtare kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë dhe lypje të detyruar me moton *"Fëmijëria nuk është shfrytëzim për punë"*. Gjatë dy viteve të fundit, MB, me iniciativën e NJAT, ka ndërmarrë një sërë masash për uljen e numrit të fëmijëve të paregjistruar në RKGJC. Gjithashtu, MB në bashkëpunim me MASH, në vitin 2011, kanë përfshirë në kurrikulën e arsimit bazë, tema për fenomenin e trafikimit të personave, përfshi edhe çështje të mbrojtjes së fëmijëve, të drejtat e fëmijëve, barazisë gjinore, dhunës në familje dhe edukimit seksual, etj. MPJ ka udhëzuar në vazhdimësi ambasadat dhe konsullatat shqiptare për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe sigurimin e identifikimit dhe referimit në kohë të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Për këtë qëllim MB në bashkëpunim me MPJ dhe IOM kanë mundur të përgatitjen e një manuali dhe kanë zhvilluar trajnime me zyrtarë të konsullatave dhe oficerë të kontaktit në vendet e rajonit dhe destinacionit. Në faqen zyrtare të internetit MPJ informon qytetarët shqiptarë jashtë vendit se si të veprojnë në rast se gjenden në një situatë trafikimi.

Në sajë të koordinimit të mirë të strukturave përgjegjëse për parandalimin e goditjen e trafikeve të paligjshme, nga viti 2009 e në vazhdim, nuk evidentohen raste në të cilat territori shqiptar të përdoret si vend tranziti për trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafiket e tjera, referuar shkëmbimit të informacionit me strukturat homologe të vendeve fqinje. Kjo situatë pozitive ka ardhur si rezultat i investigimit të të dhënave dhe informacioneve në këtë drejtim si dhe bashkëpunimit më të mirë me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit si SHISH, AIM, Forcat Detare dhe Ajrore në kontrollin e hapësirës detare dhe ajrore, me Prokurorinë, Doganat, shërbimet policore homologe të rajonit etj.

MM bazuar në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake ka kontribuar në grumbullimin e informacionit lidhur me sigurinë e hapësirës detare dhe ajrore të RSH, si dhe mbështetjen e strukturave të MB në kontrollin dhe parandalimin e trafikeve në hapësirën detare. Moratoriumi për bllokimin e plotë të lëvizjes së skafeve në det ka vazhduar, sikurse edhe ndjekjet penale dhe dënimet e trafikanteve. Bashkëpunimi i mirë me strukturat e Kufirit dhe Migracionin në PKK-të, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme e Drejtoritë Rajonale të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor ka realizuar identifikimin e metodave të aplikuara nga shtetas të huaj për të trafikuar mjete motorike dhe armë në vendin tonë.

Është forcuar bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes në operacionet e përbashkëta. Në funksion të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar kundër krimit të organizuar janë nënshkruar disa

marrëveshje bashkëpunimi dy e shumëpalëshe me vende dhe organizata rajonale e ndërkombëtare. Instalimi i linjave të sigurta të komunikimit ka sjellë rritje të ndjeshme të shkëmbimit të informacionit me EUROPOL, zyrat ndërlidhëse të vendeve të Bashkimit Evropian dhe ato të palëve të treta, të atashuara pranë këtij organizmi. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar rajonal, Shqipëria ka qenë kontributore në përgatitjen dhe miratimin e Konventës së SELEC. Si rezultat i përdorimit me efikasitet të instrumenteve të bashkëpunimit ndërkombëtar, vetëm gjatë vitit 2012 janë realizuar 54 operacione ndërkombëtare në fushën e trafikut të narkotikëve dhe 13 operacione ndërkombëtare kundër trafikeve të tjera të paligjshme.

Gjatë kësaj periudhe janë intensifikuar **marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja**, nëpërmjet anëtarësimit në një sërë aktesh ndërkombëtare (konventa dhe protokolle), si dhe janë nënshkruar disa marrëveshje të rëndësishme në fushën e drejtësisë me shtetet e rajonit dhe më gjerë. Ligji nr. 10193/2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, plotësoi rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar. Ka hyrë në fuqi Protokolli i Tretë Shtesë i Konventës Evropiane për Ekstradimin dhe duke filluar nga data 1 Gusht 2011, ka filluar të zbatohet marrëveshja e ekstradimit me Italinë. Në vitin 2012, u miratua ligji nr. 53/2012, për përcaktimin e rregullave procedurale për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it, si dhe janë nënshkruar 3 marrëveshje me Republikën e Kosovës.

Prej vitit 2006 jemi anëtarë me statusin observer në rrjetin (CARIN- Camden Assets Recovery Inter-Agency Network), dhe me përfundimin e nënshkrimit të marrëveshjes operacionale me Europolin do të bëhet anëtarësimi me të drejta të plota në rrjetin CARIN. Ky hap do të rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me ndjekjen, gjetjen, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Kjo do të kërkojë rritjen e masave në drejtim të forcimit të sistemit të brendshëm dhe bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe implementimin e direktivave të BE-s në këtë fushë.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në **luftën kundër pastrimit të parave** ka qenë në rritje me Prokurorinë, DPPP, SHISH, ZQRPP, Doganat dhe Tatimet. Është miratuar ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit dhe aktet përkatëse ligjore, duke përbushur në këtë mënyrë rekomandimet e raportit të raundit të tretë reciprok të Komitetit pranë Këshillit të Evropës, MONEYVAL si dhe ato ndërkombëtare të FATF- së (Grupi i Veprimit Financiar) si dhe rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në zbatim të këtij ligji është ngritur Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), i cili përcakton drejtimet e politikës në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Strukturat Kundër Krimit Financiar kanë punuar për përbushjen e detyrave të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale KKOTT, Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit dhe për Qeverisjen Transparente për periudhën 2008 -2013 (zbatimi i Planeve 1- vjeçare, 2009, 2010 dhe i Planit të Veprimit 3-vjeçar, 2011-2013) dhe Planit të Veprimit të hartuar në zbatim të Dokumentit Strategjik



Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar. Është forcuar bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet krijimit të 7 Njësive të Përbashkëta Hetimore pranë të cilave punojnë 30 oficerë të policisë, specialistë të strukturave të hetimit të krimit financiar.

Në fushën e **parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave**, objektivat e DPPP-së për Strategjinë Ndërsektoriale të luftës KKOTT për vitet 2008-2013, janë arritur. Janë rritur kapacitetet profesionale nëpërmjet trajnimit të mbi 2300 persona, punonjës të subjekteve raportuese dhe punonjës të institucioneve shtetërore; janë kryer mbi 900 inspekte për subjektet e ligjit, një pjesë e të cilave janë kryer në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse; janë dërguar mbi 1600 raporte për aktivitete të dyshimta, duke përfshirë një gamë të gjerë tipologjish dhe administron një bazë të konsiderueshme të dhënash; janë bërë ndryshimet e nevojshme në Ligjin nr. 9917 dt. 19.05.08 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i cili, bazuar në rekomandimet ndërkombëtare dhe nevojat e brendshme, është ndryshuar në 2011 e 2012; është intensifikuar bashkëpunimi me SHISH, me DPPSH, në lidhje me rastet e dyshuara për financim terrorizmi si dhe është kryesuar procesi i ndryshimit të ligjit për masat kundër financimit të terrorizmit. Nga DPPP janë referuar mbi 230 raste për pastrim parash në organin e akuzës (Prokurori dhe Njësi të Përbashkëta Hetimore); informuar për mbi 650 raste Policinë e Shtetit për dyshime për pastrim parash dhe financim terrorizmi; janë dërguar mbi 340 kërkesa për informacion financiar për njësitë homologe; janë nxjerrë 67 urdhra bllokimi për pasuri në një vlerë totale afro 9'000'000 Euro, pasuri për të cilat në mbi 75% të tyre është kryer sekuestrimi/konfiskimi (tregues i bazueshmërisë së dyshimeve të DPPP).

Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave kundër pasurisë" ose "Anti-Mafia", i cili hyri në fuqi në Janar të 2010, krijoi hapësirat e nevojshme juridike për ndjekjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të paligjshme që rezultojnë nga veprimtaritë kriminale dhe rriti vlerën e pasurive të sekuestruara në vitin 2011 me 2.1 herë më shumë, krahasuar me vitin 2010. U ngritën dhe forcuan kapacitetet administrative, me krijimin në Policinë e Shtetit, të strukturave të posaçme për hetimin e aseteve kriminale në nivel qendror dhe rajonal si dhe një seksion i posaçëm për hetimin e aseteve kriminale në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Në vitin 2012 është rritur numri i hetimeve kundër krimit ekonomik financiar 65 % krahasuar me vitin 2007 (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*).

Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit ka qenë në rritje me Prokurorinë, DPPP, SHISH, Departamentin Antikorrupsion, Strukturat e Kontrollit dhe Auditit, SHKB-në të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ZQRPP, AQKKP, Doganat dhe Tatimet. Treguesit e **luftës kundër korrupsionit** dhe veprave të kryera nga punonjës shtetërorë, në vitin 2012, kanë shënuar rritje me 3, 8 herë më shumë krahasuar me vitin 2007 (*Shih grafikun, Shtojca nr.1*). Gjatë vitit 2007-2012, vetëm për korrupsion janë referuar në organin e Prokurorisë 381 vepra penale. Gjatë viteve 2008-2012 janë kryer 279 operacione policore kundër krimeve financiare dhe korrupsionit.

Lufta **Kundër Terrorizmit** është dhe mbetet një nga prioritet kryesore të qeverisë shqiptare, në funksion të së cilës me VKM nr. 675, date 06.07.2011, u miratua Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit 2011 – 2015 si dhe Plani i veprimit për implementimin e saj. Në zbatim të tyre, ka vazhduar puna për parandalimin e terrorizmit nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit që marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit si SHISH, AIM, DPPPP, etj. si dhe me agjencitë rajonale dhe ndërkombëtare si OKB, SECI, EUROPOL, INTERPOL etj. Në Shtator 2012, u miratua Rregullorja për funksionimin e strukturave antiterror.

Janë fuqizuar kapacitetet administrative, ligjore dhe profesionale të strukturave të mbrojtjes së dëshmitarëve. Janë miratuar Ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”; ligji nr. 10461, datë 13.9.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, aktet nënligjore si Urdhri i Përbashkët nr. 3, datë 05.01.2011 i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për pajisjen me dokumentacion të personave të mbrojtur”, Udhëzuesi “Për përcaktimin e procedurave standarde që duhet të zbatohen nga oficerët e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e shtetasve, përfshirë edhe viktimat e trafikimit, që bashkëpunojnë me organet e drejtësisë” etj. Me urdhër të Ministrit të Brendshëm, në Shtator 2012, është bërë riorganizimi për forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve.

Për përsosjen e **infrastrukturës së operacioneve speciale policore** është investuar në rritjen e kapaciteteve teknike të kësaj strukture, si krijimi dhe vënia në eficensë të plotë e Qendrës së Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale, me investimin prej 50 mijë Euro, me qëllim përmirësimin e kushteve të ambienteve të efektivave të kësaj force si dhe investimin prej 10.7 milion lekë për aparatura dhe pajisje teknike. Sistemi TIMS është shtrirë në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit si dhe u është dhënë akses disa agjencive ligjzbatuese. Prej vitit 2008, në Policinë e Shtetit funksionon sistemi MEMEX, i cili realizon transmetimin online të informacionit për të gjithë strukturat e përfshira në luftën kundër krimit të organizuar si dhe mbledhjen, analizimin dhe mbështetjen e strukturave të tjera me produkte analitike. Analizat dhe vlerësimi i kërcënimit të krimit të organizuar krijojnë mundësi për vendimmarrje të saktë në nivelin strategjik dhe taktik.

Forcimi i kapaciteteve të Policisë Shkencore dhe fillimi i kryerjes së analizave të ADN-së, krijojnë një bazë të fuqishme për rritjen e nivelit të dokumentimit ligjor të veprave penale në fushën e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Sfidat

- Në raportin më të fundit të Komisionit European të publikuar në Tetor 2012⁵ është vlerësuar përparimi lidhur me zbatimin e masave konkrete kundër krimit të organizuar, por,
- Edhe pse Shqipëria është ende një vend burimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimi i brendshëm vazhdon të jetë shqetësim;

⁵ Progres Raporti i KE-së për Shqipërinë, Tetor 2012, f. 56-66



- Kërkohet zbatimi i një qasje ndërdisiplinore për adresimin e trafikimit të qënieve njerëzore.
- Duhet të intensifikohet përparimi për sa i përket sekuestimeve të drogave në pikat e hyrjes.
- Duhet të vazhdohet në të gjitha institucionet përkatëse me përqasjen e udhëhequr nga inteligjenca, si dhe me përdorimin në rritje të vlerësimit të rrezikut për drogat;
- Mbeten të nevojshme hetime dhe operacione më të përqendruara dhe proaktive.
- Shqipëria vazhdon të jetë prodhuesi kryesor i kanabisit në rajon.
- Grupet e krimit të organizuar vazhdojnë të përfitojnë nga vendndodhja e Shqipërisë si një vend tranzit;
- Fuqizimi i kapaciteteve të policisë për gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve me origjinë kriminale dhe rritja e rezultateteve në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave, krimit të organizuar, bazuar në vlerësimin e riskut dhe hetimin proaktiv.
- Rritja e efektivitetit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për të mbrojtur, ndihmuar dhe mbështetur viktimat e trafikimit, sidomos fëmijët.
- Duhet të mbështeten më shumë kapacitetet operacionale të laboratorit shkencor, për policimin e fshehtë dhe shërbimet për mbrojtjen e dëshmitarit.
- Për sa i përket trajtimit të trafikimit të armëve dhe municioneve, me qëllim përafrimin e legjislacionit me BE-në në këtë drejtim, ka nevojë për ndryshime;
- Duhet të intensifikohen ndjeshëm nëpërmjet koordinimit më të afërt ndërmjet autoriteteve të gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit, duke çuar në rikuperimin e efektshëm të pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme.
- Nevojitet forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale, në zbatim të akteve ndërkombëtare të fushës dhe përmbushjes së detyrimeve të parashikuara.
- Numri i dënimeve për pastrim parash mbetet i ulët ndjeshëm në krahasim me shkallën e problemit.
- Duhet të zhvillohen struktura të efektshme për të garantuar inteligjencë sigurimi me rëndësi dhe në kohën e duhur në luftën kundër terrorizmit
- Krimet e pastrimit të parave dhe korrupsionit nuk mbulohen nga Gjykata e Krimeve të Rënda.
- Bashkëpunimi operativ me vendet fqinje, Shtetet Anëtare të BE-së dhe Europol-in duhet të rritet më tej nëpërmjet shkëmbimit të inteligjencës kriminale dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.
- Hetimet proaktive si pjesë e hetimeve sistematike, të fokusuara dhe mbi baza kërcënimi në fusha dhe raste të mundshme korrupsioni sidomos të zyrtarëve të profilit të lartë, janë ende të pamjaftueshme në Shqipëri.
- Mbetet për t'u vlerësuar implementimi në praktikë i ndryshimeve kushtetuese për kufizimin e imunitetit të zyrtarëve të lartë.
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe i specializuar i punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve mbetet i nevojshëm.
- Sfidat për MIK në Shqipëri kërkojnë përmirësime të mëtejshme brenda agjencive të kufirit, si dhe në bashkëpunimin ndër agjenci e ndërkombëtar.

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër agjenci K&M në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së shkëmbimin e informacionit, procedurave për kontrole të përbashkëta, analizës së përbashkët të riskut;
- Përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar, për të zbatuar një zinxhir masash në luftën e autoriteteve kufitare kundër aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit përfshirë dhe terrorizmin.

Kapitulli 2. Vizioni, Politikat dhe Qëllimet Strategjike

Vizioni:

Shqipëria të jetë vend i një shoqërie pa kërcënime nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, që ofron imazhin e një shteti të qetë dhe me standarde të larta të sigurisë.

Synimi strategjik afatgjatë i implementimit të kësaj strategjie është që Shqipëria të jetë një vend i aftë për të garantuar një shoqëri ku të sundojë ligji, për të krijuar një mjedis sa më të sigurt për shoqërinë shqiptare dhe duke minimizuar kërcënimet e krimit të organizuar dhe terrorizmit, që do të sjellë përmirësim në cilësinë e jetës dhe sigurisë së qytetarëve, duke e bërë Shqipërinë një vend me standarde evropiane të sigurisë.

Ky vizion është i lidhur ngushtë me përcaktimin e përgjegjësive të çdo institucioni, ndërtimin e infrastrukturës së plotë ligjore sipas standardeve të BE-së, rritjen e kapaciteteve e aftësive tekniko-profesionale dhe operacionale, zbatimin cilësor të masave e detyrave të parashikuara në planet e veprimit të strategjive të tjera të lidhura me të, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe implementimin sipas fazave të kësaj strategjie.

Politikat, Qëllimet dhe Objektivat Strategjike në luftë kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit:

Strategjia synon të zhvillojë politikat e duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë në vend, nëpërmjet:

- rritjes së efikasitetit të standardeve të menaxhimit të personelit në çdo agjenci apo strukturë;
- rritjes së kapaciteteve operacionale dhe goditjes së krimit të organizuar bazuar në vlerësimin e kërcënimeve dhe hetimeve proaktive;
- rritjes së bashkëpunimit me strukturat e brendshme dhe partnerët rajonalë të BE-së si dhe institucionet relevante të sistemit të Kombeve të Bashkuara për luftën ndaj krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, krimit financiar dhe korrupsionit, duke krijuar një "track record" solid me hetimet proaktive;
- ndjekjes dhe dënimit të çështjeve të korrupsionit në të gjitha nivelet dhe sidomos ato të profilit të zyrtarëve të lartë;
- rritjes së kapaciteteve investiguese dhe orientimit të këtyre strukturave drejt inteligjencës;
- rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve për aplikimin e teknologjive të reja në zbulimin dhe identifikimin e provave ligjore;



- rritjes së efikasitetit në fushën e ndjekjes, gjetjes, ngrirjes, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të produkteve të krimit të organizuar;
- rritjes dhe forcimit të masave në drejtim të parandalimit të akteve terroriste dhe ekstremizmit;
- rritjes së efikasitetit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Për zbatimin e këtyre politikave do të punohet për të rritur dhe forcuar më tej kapacitetet administrative të institucioneve shtetërore për të siguruar një shërbim investigativ bashkëkohor që realizon parandalimin, hetimin, dhe goditjen e veprimtarisë kriminale nëpërmjet aplikimit të teknikave speciale të hetimit, modelit të inteligjencës kriminale, si dhe forcimin e masave që synojnë rritjen e parametrave të sigurisë në vend, për të siguruar një jetë më të mirë për qytetarët shqiptarë dhe vizitorët e huaj në vend. Gjithashtu, do të punohet për realizimin e një koordinimi dhe cilësie më të lartë të veprimtarisë të institucioneve ligjzbatuese në drejtim të thellimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, për të garantuar një vend sa më të sigurt për të gjithë.

Qëllimet strategjike janë organizimi dhe koordinimi i veprimtarisë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, duke synuar ndërtimin e një shoqërie, pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe e në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e imazhit të një vendi të qetë e me standarde të larta sigurie; të një vendi ku zbatohet rigorozisht ligji dhe respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, të një vendi që aspiron të radhitet me shtetet që luftojnë me efektivitet krimin e organizuar, si një partner me garanci të plota e standarde për të qenë anëtar i familjes së Bashkimit Evropian.

Detyrimet në kuadrin e integritetit dhe marrjes së statusit të vendit kandidat si dhe angazhimet ndërkombëtare që rrjedhin nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare apo qenia shtet-palë në instrumentet/konventat ndërkombëtare të fushës, shtrojnë domosdoshmërinë e angazhimit të Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve, mjeteve motorike dhe terrorizmin. Detyrimet e mësipërme përbëjnë një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në paqen dhe stabilitetin rajonal.

Agjencitë e zbatimit të ligjit janë plotësisht të angazhuara në forcimin e luftës ndaj fenomenit të krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standardeve të kërkuara dhe plotësimin e angazhimeve të marra. Nga ana e BE-së kërkohet angazhimi i Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të

armëve dhe të makinave etj.

Qëllimet strategjike u identifikuan duke marrë në konsideratë situatën aktuale të krimit të organizuar në Shqipëri, prioritet qeverisëse për periudhën 2009-2013, detyrimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-së 2012-2015, nga SKZHI 2013-2020, 12 Rekomandimet e Opinionit të KE-së për Shqipërinë dhe detyrimet e strategjive të tjera që janë në fazën e implementimit dhe që janë hartuar për luftën kundër formave të veçanta të shfaqjes së krimit të organizuar, si strategjia e luftës kundër drogës, plani kombëtar i veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, strategjia e luftës kundër terrorizmit etj., si dhe nisur nga impakti që kanë këto dukuri mbi shoqërinë shqiptare si dhe në imazhin e vendit tonë tek partnerët ndërkombëtarë.

Kapitulli 3 Objektivat e Politikës dhe Produktet Madhore

Për të arritur këto qëllimet e mësipërme, dokumenti strategjik përcakton objektivat kryesore si më poshtë:

- A. Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit,
- B. Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm;
- C. Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit dhe terrorizmit.
- D. Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve e municioneve luftarake, të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës, duke bashkëpunuar me gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit.
- E. Forcimi i integritetit të zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe reduktimi i korrupsionit.
- F. Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave nëpërmjet rritjes së treguesve të luftës kundër tij.
- G. Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shënjestrit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.
- H. Zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut dhe duke bashkëpunuar me strukturat e shtetit të angazhuara në këtë fushë.
- I. Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së.
- J. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- K. Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë Shkencore
- L. Rritja e efektivitetit të strukturave kundër krimit kompjuterik



Objektivat Strategjike dhe Treguesit e Performancës

A. Forcimi i koordinimit ndërinstitutional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit,

Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme do të mbetet përsëri si një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare, kjo për faktin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Lufta kundër krimit të organizuar do të intensifikohet nëpërmjet përpjekjeve të koordinuara dhe harmonizuara të të gjithë institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese Shqiptare që janë të përfshira dhe që kanë detyrime në këtë strategji.

Koordinimi ndërinstitutional do të synojë në përmirësimin e organizimit dhe koordinimit të veprimtarisë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, akteve terroriste, krimit ekonomiko-financiar dhe korrupsionit si dhe hetimit të aseteve kriminale, në rritjen e shkëmbimit të informacioneve, realizimin e aktiviteteve trajnuese dhe analizave të përbashkëta, rritjen e aksesit në databaset e secilit institucion, si dhe vazhdimin e raportimit të statistikave të përbashkëta nëpërmjet track recordeve.

B. Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm;

Lufta kundër drogave

Qeveria Shqiptare, në përputhje me Strategjinë kombëtare kundër drogës 2012-2016, synon mbrojtjen e sigurisë publike, jetës dhe shëndetit të individëve e komuniteteve nëpërmjet minimizimit të rrezikut dhe të dëmeve që vijnë nga droga përmes një veprimi të koordinuar kombëtar. Lufta kundër grupeve dhe organizatave kriminale do të vazhdojë të mbetet në qendër të vëmendjes së strukturave ligjzbatuese në vendin tonë. Rritja e efikasitetit në këtë veprimtari, kërkon ngritjen në nivel më të lartë të bashkëpunimit mes institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit brenda vendit si MB, MD, MF, MM, MBUMK, MPJ, por edhe Policia e Shtetit, Doganat, Prokuroria dhe SHISH. Në këtë drejtim, është e nevojshme të vazhdojë me intensitet puna për përgatitjen e rezultateve të qëndrueshme të drejtuara nga hetimet proaktive. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar është një kusht tjetër i domosdoshëm për efikasitet në goditjen e rrjeteve kriminale të trafikimit ndërkombëtar të narkotikëve. Shqipëria, po luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare kundër drogës, kontribut i njohur edhe nga partneret dhe organizmat ndërkombëtare. Qëllimi ynë është që ta ngrejmë në nivele më të larta këtë bashkëpunim ndërinstitutional. Një drejtim tjetër i rëndësishëm është ulja e mëtejshme e prodhimit të kanabisit.

C. Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit dhe terrorizmit.

Rritja e efektshmërisë dhe eficiencës në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit do të realizohet nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes së numrit të hetimeve proaktive nga strukturat përgjegjëse. Ky objektiv do të rezultojë në goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve policore bazuar në analizën e informacionit kriminal dhe mjetet speciale të hetimit, duke marrë në konsideratë Policimin e Udhëhequr nga Inteligjenca.

Kjo filozofi do të realizohet duke marrë në konsideratë rekomandimet e produkteve analitike "Vlerësimi i kërcënimit të krimit të organizuar", "Vlerësimi i grupeve kriminale", përdorimin me efikasitet të teknikave speciale të hetimit, duke synuar në rritjen me 5 % të numrit të përgjithshëm të hetimeve proaktive.

D. Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve e municioneve luftarake, të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës, duke bashkëpunuar me gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit.

Lufta kundër Trafikeve të tjera të Paligjshme, bazohet në Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore" e dokumentin plotësues "Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit", 2011 - 2013 si dhe në planet e veprimit përkatëse për çdo formë të trafikut të paligjshëm. Implementimi i këtyre dokumenteve do të thellojë më tej masat në drejtim të goditjes e parandalimit të këtyre trafikeve.

Për periudhën në vazhdim do të intensifikohen përpjekjet e strukturave shtetërore për të luftuar fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke pasur si objektiv kryesor hetimin, gjykimin dhe dënimin e trafikantëve dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Një objektiv, në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, do të jetë edhe përmirësimi i legjislacionit që rregullon fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti i legjislacionit penal dhe njehsimi i tij me standardet më të larta ndërkombëtare dhe me legjislacionin e BE-së. Gjithashtu, do të synohet identifikimi i hershëm i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, me qëllim referimin e tyre për shërbime dhe sigurimin e një mbrojtjeje efektive, bazuar gjithmonë në interesin më të lartë të viktimës, me një qasje të veçantë ndaj fëmijëve. Sërish do të jenë në qendër të vëmendjes fushatat ndërgjegjësuere për të gjithë shoqërinë, në veçanti për grupet e veçanta më të rrezikuara nga trafikimi. Do të zhvillohen studime dhe kërkime për të realizuar parandalimin në kohë të shfaqjeve të formave të reja të trafikimit, apo llojeve të reja të shfrytëzimit.

Strukturat e Policisë së Shtetit do të fokusohen në parandalimin dhe reduktimin e trafikeve të paligjshme nga/përmes vendit tonë duke forcuar bashkëpunimin me vendet e originës, transitit dhe destinacionit në shkëmbimin e informacionit, kryerjen e hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta, në forcimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe përdorimit të metodave speciale të hetimit, në përmirësim dhe harmonizimin në sigurimin e të dhënave dhe statistikave që mundësojnë vlerësimin e progresit në luftën kundër trafikut



të armëve, veprave të artit, mjeteve motorike dhe kontrabandimit të migrantëve dhe *track record-et* aktuale.

Drejtimet kryesore ku do të përqendrohet lufta kundër trafikëve të paligjshme do të jenë: lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore; kundër trafikut të armëve dhe municioneve luftarake; kundër trafikut të paligjshëm të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës; parandalimi dhe minimizimi i kontrabandimit të personave.

E. Forcimi i integritetit të zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe reduktimi i korrupsionit.

Lufta kundër korrupsionit është e lidhur ngushtësisht me luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, gjë që kërkon një bashkëpunim të thelluar mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe atyre të inteligjencës. Për të arritur këtë objektiv strategjik, kërkohet parandalimi dhe reduktimi progresiv i korrupsionit, forcimi i integritetit të policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, rritja e treguesve në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të hetimit të korrupsionit, evidentimit dhe dokumentimit sa me efektiv të hetimeve për korrupsion, krijimit të një sistemi të konsoliduar të dhënash për regjistrimin e hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në fushën e korrupsionit të zyrtarëve të profilin të lartë si dhe rritjes së besimit të publikut tek strukturat shtetërore të luftës kundër korrupsionit.

F. Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave nëpërmjet rritjes së treguesve të luftës kundër tij.

Masat për parandalimin e pastrimit të parave do të sjellin reduktimin e aktiviteve të krimit të organizuar, dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik në vend, që janë prioritet i Qeverisë Shqiptare.

Qeveria Shqiptare do të bashkëpunojë me vendet e tjera me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga aktivitetet kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të mbështetet në zbatimin e standardeve dhe mekanizmave të përshtatshme, për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standardet e BE-së, kërkesave që rrjedhin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

Synimet kryesore në mbështetje të strategjive, prioritetëve të Qeverisë dhe rekomandimeve të KE-së për vitet në vijim do të jenë:

- Rishikimi periodik i efektivitetit dhe frytshmërisë së sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të hetimit të pastrimit të parave dhe rritjes së treguesve në luftën kundër tij si dhe krijimit

- të një sistemi të konsoliduar të dhënash lidhur me regjistrimin e hetimeve, ndjekjen penale dhe dënimeve në fushën e pastrimit të parave.
- Sigurimi i aksesit online për autoritetet e hetimit të krimit financiar në regjistrat e pasurive, të biznesve, liçensave, automjeteve, legalizimeve, tatimeve, doganave, regjistrin kombëtar të llogarive bankare, institucionet financiare dhe baza të tjera të dhënash.
 - Rregullimi me ligj ose marrëveshje të përbashkëta, bashkëpunimi për shkëmbimin online të informacionit me FIU-n, QKR, TATIMET, Dogana, AAPSK, ALUIZNI, QKL, ZQRPP dhe me agjenci të tjera të zbatimit të ligjit.
 - Hartimi dhe zbatimi i programeve ndërinstitucionale të përbashkëta të trajnimit, me përfshirjen nga të gjitha autoritetet kompetente të mbledhjes, dhënies së informacionit financiar, analizës së informacionit financiar, investigimit të pastrimit të parave, dhe gjetjes së aseteve kriminale, dhe deri nga struktura e gjyqësorit në këtë fushë.
 - Bashkëpunimi intensiv me institucionet ndërkombëtare të fushës dhe sidomos me strukturat relevante të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

G. Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shënjestrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal

Synimet kryesore në hetimin e aseteve kriminale deri në vitin 2020 do të jenë:

- Ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", që synojnë shtimin e gamës së veprave penale si dhe lehtësimin e procedurave në hetimin e pasurive që rrjedhin nga aktivitetet kriminale.
- Rritja dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në hetimin e aseteve kriminale, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme e të përbashkëta, krijimit të një sistemi statistikor ndërinstitucional.
- Rritja e numrit të hetimeve pasurore me qëllim rritjen e numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve, nëpërmjet krijimit të lehtësirave dhe aksesit në sistemin e informatizuar të pasurive; rritjes së bashkëpunimit ndërmjet strukturave të policisë, institucione të tjera dhe në nivel ndërkombëtar, e sidomos me ato të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rritjes së monitorimit në zbatimin e detyrimeve ligjore.

H. Zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut dhe duke bashkëpunuar me strukturat e shtetit të angazhuara në këtë fushë

Shqipëria angazhohet plotësisht për të përmbushur në mënyrë aktive dhe të përkushtuar me të gjithë detyrimet dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit, duke e konsideruar atë si rrezikun dhe armikun numër një të pages, sigurisë dhe demokracisë në botë.



Veprimtaria e strukturave kundër terrorizmit do të mbështetet në katër elementë të rëndësishëm: Parandalimi, Ndjekja, Mbrotjtja dhe Reagimi nëpërmjet të cilave synohet realizimi i objektivave të mëposhtëm:

- Përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së lidhur me luftën kundër terrorizmit, si dhe akteve të tjera radikaliste e ekstremiste, bazuar në strategjitë e tjera, si dhe në planet e veprimit.
- Identifikimi i analizës e situatës së grupeve kriminale që kryejnë, apo dyshohet se kryejnë vepra penale lidhur me terrorizmin dhe evidentimi dhe parandalimi i rasteve dhe fenomeneve lidhur me radikalizmin dhe ekstremizmin, që frymëzohen nga grupet terroriste si Al Kaida dhe organizatat e tjera terroriste.
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët e strukturave të luftës kundër terrorizmit dhe shfrytëzimit të eksperiencave të vendeve të tjera në këtë fushë.
- Forcimi dhe realizimi i një kontrolli efektiv të kufirit shtetëror, si dhe të të huajve të dyshimtë, duke iu përafëruar standardeve të vendeve të BE-së.
- Thëllimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit, e sidomos me ato të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Realizimi i ndjekjes, parandalimit, mbrotjtjes dhe reagimit ndaj fenomeneve që prodhojnë radikalizëm dhe ekstremizëm nga persona apo grup personash, të evidentuar në fazën e parë dhe të dytë të kësaj strategjie, duke identifikuar me moton “se asnjë person apo grup kriminal që kryen krime të formave të krimit të terrorizmit nuk do t’i shpëtojë ndëshkimit të ligjit”.

I. Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së.

Menaxhimi i integruar dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të Qeverisë Shqiptare si në raport me detyrimet ligjore, politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht në procesin e marrjes së statusit si vend kandidat të Shqipërisë për në BE, rritjen e besimit ndaj shteteve fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Politika për realizimin e kufijve të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt kërkon menaxhim eficient të kufirit duke u angazhuar të punojë së bashku me vendet e rajonit për të arritur atë në shkallë rajonale.

Forcimi i kontrolleve në kufi do të synojë të:

- Pengojë kriminelët të kryejnë aktivitete ilegale ndërkufitare, duke parandaluar ose duke zbuluar aktivitetet e tyre.
- Forcojë luftën ndaj trafikeve të të gjithë llojeve, imigracionit të paligjshëm, terrorizmit dhe krimit të organizuar,

- Forcojë kontrollin e kufirit, duke e konsideruar mjaft të dobishëm dhe eficient për parandalimin e zhvillimit dhe përhapjes së krimit, ndëshkimin e kriminelëve dhe pakësimin e përfitimeve të tyre të paligjshme.

Përparësitë strategjike dhe objektivat e politikave do të jenë:

- Përmirësimi i menaxhimit të procesit të kalimit të kufirit për lehtësimin e kalimit të ligjshëm dhe parandalimin e aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror;
- Përfundimi i harmonizimit të kuadrit ligjor me standardet Schengen deri në vitin 2018 për të 4 shtyllat e MIK-ut.
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve;
- Parandalimi dhe ulja e imigrimit të paligjshëm nëpërmjet zbatimit të masave dhe veprimeve të Planit të Veprimit të Strategjisë së MIK-ut dhe normativën migratore;
- Forcimi i kapaciteteve të vlerësimit të kërcënimit në PK&M.

Institucionet kombëtare (sidomos doganat, policia kufitare, autoritetet fito-sanitare, etj.), nëpërmjet implementimit të këtyre strategjive do të forcojnë bashkëpunimin ndërinstytucional, për t'i bërë PKK-të më eficiente, si për sa i përket flukseve të mallrave dhe personave, ashtu edhe për sa i përket kontrollit të aktiviteteve kriminale ndërkufitare.

J. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal në luftë kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, terrorizmit dhe emigracionit ilegal, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare.

Në kuadrin e integritetit të vendit në BE, kërkohet angazhimi i Shqipërisë për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave etj.

Në këtë kuadër, kërkohet konsolidimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në drejtim të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurave të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar; rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere të zbatimit të ligjit nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të operacioneve të përbashkëta kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme si dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e hetimeve të përbashkëta.

K. Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë Shkencore

Përmbushja e qëllimeve strategjike do të realizojë objektivat specifike dhe produktet madhore si më poshtë:

- Rritjes së kapaciteteve në drejtim të ekzaminimeve me anë të ADN-së, nëpërmjet instalimit të database-s të ADN-së, për ruajtjen e profileve të personave me të dhëna kriminale dhe krahasimet me profilet e mbetjeve biologjike të fiksuara në vendngjarje.



- Rritjes së kapaciteteve përpunuese dhe ekzaminuese të provave dixhitale filmike nëpërmjet implementimit të protokolleve të përmirësimit të cilësisë së pamjeve filmike ekzistuese, dhe programeve e pajisjeve ekzaminuese.

L. Rritja e efektivitetit të strukturave kundër krimit kompjuterik

Në funksion të rritjes së efektivitetit të luftës kundër krimit kompjuterik në të ardhmen parashikohet të rriten kapacitetet administrative të strukturave përkatëse nëpërmjet zgjerimit dhe forcimit të tyre. Për këtë qëllim do të:

- Krijohet një njësi e vetme e specializuar për hetimin dhe ekzaminimin krimeve kompjuterike në nivel qendror e rajonal,
- Zgjerohet gama e hetimit të aktivitetit kriminal nëpërmjet kompjuterëve dhe Internet-it, duke përfshirë mashtrimet me kartat bankare, mashtrimet në internet, sistemet dhe rrjeti kompjuterik.
- Krijohet struktura për luftën kundër abuzimit me të mitur ose pedopornografisë,
- Ofrohet shërbim për të gjitha strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit, që do të zhvillojnë hetime dhe ekzaminime lidhur me krimet kompjuterike dhe Internet-in.

Indikatorët e Performancës dhe Objektivat Specifike

A. Forcimi i koordinimit ndërinstitutional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit:

Objektiva specifike:

1. Zbatimi i aktiviteteve bashkëpunuese të parashikuara në Planet Kombëtar të Veprimit, për luftën kundër narkotikëve, terrorizmit, trafikëve të tjera të paligjshme, si veprat e artit, mjetet motorike, pastrimit të parave dhe korrupsionit.
2. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet institucioneve pjesë e kësaj strategjie, dhe strategjive të tjera përbërëse, nëpërmjet dhënies së aksesit në databaset e çdo institucioni.
3. Krijimi i një sistemi të konsoliduar të dhënash (track rekord) lidhur me regjistrimin e hetimeve të krimit të organizuar, krimit financiar dhe korrupsionit.
4. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional nëpërmjet trajnimeve dhe analizave të përbashkëta në fushën e hetimit të aseteve kriminale

Indikatorët:

- Plotësimi periodik, çdo 3 – mujour i statistikave të konsoliduara dhe rakorduara.
- Takimet periodike me të gjithë institucionet e tjera raportuese, çdo 3- mujour.

- Numri i informacioneve të shkëmbyera mes institucioneve do të rritet me 5% në vitin 2020, krahasuar me vitin 2012.
- Numri i trajnimeve të përbashkëta do të rritet 4 % në vitin 2020, krahasuar me vitin 2012.
- Sigurimi i aksesit në të dhënat e ALUZNIT, ZQRPP, Taksave, Doganave. (2014)
- Sigurimi i aksesit në të dhënat e FIU, DPSHTRR, QKR, QKL etj. (2014)
- Sigurimi i aksesit në të dhënat e ALUZNIT, ZQRPP, Taksave, Doganave. (2014)

B. Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm:

Objektivat specifike:

1. Parandalimi dhe ulja në mënyrë të ndjeshme e prodhimit të drogës në Shqipëri;
2. Vështirësimi i aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm nëpërmjet goditjes me intensitet të lartë të individëve, grupeve apo organizatave kriminale që ushtrojnë veprimtari kriminale në formën e shitjes, shpërndarjes, trafikut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar të drogave.
3. Përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit në fushën e drogës;
4. Forcimi i kapaciteteve të njësive të specializuara për luftën kundër drogës nëpërmjet trajnimit e pajisjes së tyre me mjetet dhe pajisjet e nevojshme.
5. Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin e goditjes e trafikimit ndërkombëtar të drogave.

Indikatorët:

- Ulja, deri më 2016, me 50% e numrit të kapjeve dhe bimeve të asgjësuar për rastet e kultivimit të bimëve narkotike, duke u nisur nga të dhënat e vitit 2010.
- Numri i kapjeve për rastet e shitjes e trafikimit të drogave, të jetë çdo vit mbi 600.
- Mbajtja në nivele të ultë e treguesve për sasi të drogave të forta të sekuestruara nga vendet fqinje me origjinë apo të tranzituara nga Shqipëria (nën 20 kg heroinë dhe nën 5 kg kokainë deri në vitin 2020).
- Kryerja çdo vit e jo më pak se 30 operacioneve ku janë përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Goditja çdo vit e jo më pak se 40 grupe kriminale të trafikut e shpërndarjes së drogave.
- Rritja e zbulueshmërisë dhe goditjes së trafikut të lendeve narkotike në VKK me 1.5 % në vitin 2020 në raport me vitin 2011.



C. Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit dhe terrorizmit.

Objektivat specifike:

Indikatorët:

1. Rritja e numrit të operacioneve me metodat speciale të hetimit të trafikeve të paligjshme me 5 % deri në vitin 2015 dhe 7 % deri në vitin 2020, krahasuar me 2012.
2. Kryerja çdo vit e jo më pak se 50 operacioneve kundër narkotikëve me teknikat speciale hetimore.
3. Rritja me 5 % e numrit të hetimeve proaktive për pastrim të produkteve të veprës penale.
4. Rritja me 5 % çdo vit e hetimeve proaktive në fushën kundër korrupsionit.

D. Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve e municioneve luftarake, të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës, duke bashkëpunuar me gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit.

Objektivat specifike:

1. Përmirësimi i legjislacionit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe zbatimi i mekanizmave dhe procedurave të standardizuara për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, me një qasje të veçantë ndaj fëmijëve;
 - 1.1. Ndryshimi i KP dhe KPr.P me qëllim përmirësimin e dispozitave ekzistuese dhe shtimin e disa dispozitave të reja për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore;
 - 1.2. Hartimi dhe miratimi i një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, i cili do të shërbejë edhe si një instrument efektiv për të adresuar në një akt të vetëm të gjitha masat që duhen ndërmarrë në luftën kundër trafikimit të personave;
 - 1.3. Monitorimi dhe zbatimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit nëpërmjet udhëzimeve të vazhdueshme dhe monitorimit në mënyrë proaktive me qëllim garantimin e procesit të identifikimit dhe referimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
2. Përqasja e legjislacionit kundër trafikimit të armeve dhe municioneve nëpërmjet implementimit të Konventës së OKB Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokolleve shtesë.
3. Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në planin e veprimit për luftën kundër trafikimit të veprave të artit e kulturës, mjeteve motorike si dhe parandalimin dhe luftën kundër kontrabandimit të migrantëve.
4. Intensifikimi dhe goditja e rrjeteve kriminale dhe individëve të përfshirë në aktivitetet kriminale të trafikeve të paligjshme.

- 5 Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve e municioneve luftarake, të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës, duke bashkëpunuar me gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit.
 - 5.1 Vazhdimi i fushatave ndërgjegjëse me përfshirjen aktive të strukturave shtetërore, pushtetit vendor, medias, shoqërisë civile, biznesit dhe të gjithë aktorëve të tjerë që kanë një rol në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave;
 - 5.2 Ndërgjegjësimi që në moshë të herët i fëmijëve për të drejtat që ata gëzojnë dhe fuqizimi i tyre përmes sistemeve të mbrojtjes, arsimimit, nxitjes dhe favorizimit;
 - 5.3 Kryerja dhe nxitja e kërkimeve dhe studimeve serioze në fushën e trafikimit të personave për të bërë një hartim dhe planifikim efektiv të makro politikave kundër trafikimit të personave;
 - 5.4 Unifikim i Katalogut për humbjet në bazat e të dhënave të QKIAK me ASF 2 Interpol në mënyrë që të bëhet një shkëmbim korrekt dhe në kohë i informacionit në nivel ndërkombëtar dhe që të plotësohen të dhënat mbi objektet e humbura sipas formatit të Interpol.

Indikatorët:

1. Përqindja e veprave penale të trafikimit të paligjshëm të zbuluara, do të rritet nga 98.2% në 98.7% më 2020;
2. Rritja e zbulueshmërisë të veprave penale për trafike të paligjshme me 1.4 % në vitin 2020, krahasuar me 4.99 % në vitin 2012, në sajë të implementimit të sistemit të INTERPOL-it dhe sistemit TIMS.
3. Rritja e profesionalizmit dhe kapaciteteve teknike për goditjen e fenomenit të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kalimin e kufirit. Mbajtja e zbulueshmërisë së dokumenteve të falsifikuara në nivelin 100% deri në vitin 2020.

E. Forcimi i integritetit të zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe reduktimi i korrupsionit.

Objektivat specifike:

1. Fuqizimi i kapaciteteve të hetimit të korrupsionit, evidentimi dhe dokumentimi sa më i plotë i hetimeve për korrupsion;
 - 1.1 Vënia në dispozicion të publikut të një linje telefonike falas dhe adrese e-mail, për denoncimin e rasteve të korrupsionit;
 - 1.2 Kryerja e trajnimeve të përbashkëta me prokurorinë dhe agjencitë e tjera në fushën e hetimit të korrupsionit;
 - 1.3 Rritja e numrit të hetimeve dhe numrit të operacioneve policore në fushën e korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve në detyrë.



Indikatorët:

- Numri i procedimeve penale të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve në detyrë do të rritet 2, 5 herë deri në vitin 2016 dhe 3,5 herë deri në vitin 2020
- Rritja me 5% e numrit të operacioneve me teknika speciale të hetimit, çdo vit.

F. Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave nëpërmjet rritjes së treguesve të luftës kundër tij.

Objektivat specifike:

1. Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave dhe rritja e treguesve për luftën kundër tij;
 - 1.1 Rritja e numrit të rasteve të hetimeve paraprake dhe rasteve nën hetim të pastrimit të parave;
 - 1.2 Rritja e rasteve dhe vlerës së aseteve të sekuestruara e konfiskuara për shkak të veprave penale të pastrimit të parave;
 - 1.3 Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetit profesional të strukturave të hetimit të pastrimit të parave;
 - 1.4 Rritja e efikasitetit të sistemit parandalues të pastrimit të parave;
2. Ulja e transaksioneve në para fizike nëpërmjet masave komplekse;
 - 2.1 Ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të legjislacionit të fushës nga subjektet e ligjit si dhe nga institucionet e përfshira;
3. Rritja e kapaciteteve trajnuese të strukturave të hetimit të pastrimit të parave;
 - 3.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve ndër-institucionale të përbashkëta të trajnimit;
4. Përshtatja e legjislacionit vendas me rekomandimet përkatëse të FATF, BE-së, KiE-së etj;
 - 4.1 Rishikimi periodik i efektivitetit dhe frytshmërisë së sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Indikatorët:

- Numri i procedimeve penale të veprave penale të pastrimit të parave, do të rritet me 10 % deri në vitin 2016;
- Rritja e numrit të rasteve dhe e vlerës së aseteve të konfiskuara për pastrim parash në 5% çdo vit;
- Rritja me 5 % e raporteve të aktivitetit të dyshimtë nga subjektet e ligjit;
- Numri i trajnimeve të përbashkëta do të rritet me 5 % në vitin 2020, krahasuar me vitin 2012.

G. Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shënjestrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal

Objektivat Specifike:

1. Rishikimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore në drejtim të gjetjes, sekuestrimit, konfiskimit të aseteve kriminale
 - 1.1 Inicimi i ndryshimeve në ligjin nr 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", që synojnë shtimin e gamës së veprave penale si dhe lehtësimin e procedurave në hetimin e pasurive që rrjedhin nga aktivitetet kriminale.
 - 1.2. Rishikimi i akteve të tjera nënligjore që përmirësojnë veprimtarinë në drejtim të identifikimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe menaxhimit të këtyre pasurive.
2. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve profesionale në hetimin e pasurive kriminale.
 - 2.1. Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese të përbashkëta me institucione tjera që mbartin detyrime nga ligji nr. 10192 (antimafia).
 - 2.2. Zhvillimi i takimeve dhe analizave periodike me qëllim përmirësimin e veprimtarisë hetimore dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e ligjit.
 - 2.3. Shkëmbimi i eksperiencës dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerët.
3. Rritja e numrit të hetimeve pasurore shoqëruar me rritjen e numrit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.
 - 3.1 Rritja e bashkëpunimit me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe strukturat e policisë që hetojnë veprat penale objekt i fushës së zbatimit të ligjit.
 - 3.2 Rritja e cilësisë së hetimeve pasurore, nëpërmjet rritjes së monitorimit dhe analizave të posaçme mes strukturave të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë për Krime të Rënda.
 - 3.3 Rritja e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.
4. Rritja e forcimit të mëtijshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar.
 - 4.1. Rritja e shkëmbimit të informacioneve.
 - 4.2. Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe operacionale.
 - 4.3. Shkëmbimi i eksperiencave me të mira etj.

Indikatorët:

- Rritja e numrit të hetimeve pasurore me 10 % deri në vitin 2016;
- Përmirësimi i dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me krijimin dhe një Fondi të posaçëm për kompensimin e viktimave të krimit, në veçanti viktimat e trafikimit;

H. Zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut dhe duke bashkëpunuar me strukturat e shtetit të angazhuara në këtë fushë.



Objektivat Specifike:

1. Forcimi i masave parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese kundër terrorizmit
 - 1.1 Forcimi i masave për të siguruar evidentimin sa më të plotë të grupeve dhe individëve ekstremistë që nxisin dhe mbështesin dhunën, nëpërmjet rritjes së numrit të **hetimeve proaktive** për parandalimit e akteve të mundshme terroriste në vendin tonë apo nëpërmjet vendit tonë.
 - 1.2 Implementimi i Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorit, nga të gjitha institucionet sipas fazave që përcakton kjo strategji.
 - 1.3 Analiza e situatës së grupeve kriminale që dyshohen për vepra penale të lidhura me terrorizmin që frymëzohen nga grupet terroriste si Al Kaida dhe grupe të tjera terroriste.
 - 1.4 Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me kujdesin dhe vigjilencën për parandalimin dhe zbulimin e terrorizmit dhe ekstremizmit.
 - 1.5 Realizimi i ndjekjes, parandalimit, mbrojtjes dhe reagimit ndaj fenomeneve që prodhojnë radikalizëm dhe ekstremizëm nga persona apo grup personash, të evidencuara në fazën e parë dhe të dytë të kësaj strategjie, duke identifikuar moton “se asnjë person apo grup kriminal që kryen krime të formave të krimit të terrorizmit nuk do t’i shpëtojë ndëshkimit të ligjit”.
 - 1.6 Forcimi dhe realizimi i një kontrolli efektiv të kufirit shtetëror, si dhe të të huajve të dyshimtë, duke iu përafruar standardeve të vendeve të BE-së.
 - 1.7 Vlerësimi institucional i rrezikut sipas drejtimeve⁶, periodikisht (6-mujor, një vjeçar);
 - 1.8 Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me shërbimet informative të vendeve të huaja, për raste, situata, dukuri dhe fenomene, sipas drejtimeve dhe sipas nivelit të bashkëpunimit që kemi me këto shërbime;
 - 1.9 Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me institucionet ligjzbatuese (NjPH-të, Policinë, DPPPP/NjIF dhe DPD, DPT, AIM, etj.) për çështje konkrete, dukuri e fenomene, sipas drejtimeve;
 - 1.10 Mbështetja informative për veprime operative të përbashkëta me njësitë e zbatimit të ligjit.
2. Përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së, dhe kërkesave të instrumenteve ndërkombëtarë lidhur me luftën kundër terrorizmit, si dhe akteve të tjera, bazuar në strategjitë e tjera, si dhe në planet e veprimit.
- 2.1 Forcimi i masave dhe marrja e iniciativave ligjore për kontrollin e armëve të zjarrit, eksplozivave, biologjike, kimike, radioaktive.

⁶ Terrorizmi, krimi i organizuar, trafiket, krimi ekonomik e financiar, pastrimi i produktit kriminal e pastrimi i parave si dhe korrupsionit.

3. Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat që kryejnë veprimtari kundër krimit të terrorizmit dhe shfrytëzimin e eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim.
4. Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit.

4.1 Kryerja e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit e gjykimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese.

Indikatorët:

- Rritja me 5% e hetimeve proaktive ndaj ekstremistëve që mbështesin dhunën e kanë tendencë terroriste;
- Përditësimi i Listave të Këshillit të Sigurimit për individë dhe grupe mbështetës të terrorizmit;
- Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për armët", viti 2013;
- Numri i trajnimeve do të rritet me 3 % në vitin 2020, krahasuar me vitin 2012.

I. Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-se.

Objektivat specifikë:

1. Forcimi i masave për kontrollin dhe menaxhimin e kufirit shtetëror për të parandaluar krimet ndërkufitare dhe trafiket e paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë.
 - 1.1 Përmirësimi i menaxhimit të procesit të kalimit të kufirit për lehtësimin e kalimit të ligjshëm dhe parandalimin e aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror.
 - 1.2 Përfundimi i harmonizimit të kuadrit ligjor me standardet Schengen deri në vitin 2018 për të 4 shtyllat e menaxhimit të integruar të kufijve
 - 1.3 Parandalimi dhe ulja e imigrimit të paligjshëm nëpërmjet zbatimit të masave dhe veprimeve të Planit të Veprimit të Strategjisë së MIK-ut dhe normativën migratore
 - 1.4 Zhvillimi i infrastrukturës dhe forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve;
2. Forcimi i kapaciteteve të vlerësimit të kërcënimit në Policinë e Kufirit & Migracionit
 - 2.1 Forcimi i analizës së riskut dhe informacionit kriminal në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (IMOC-QNOD).
 - 2.2 Përmirësimi i Politikave dhe procedurave të funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).



Indikatorët

- Ulja e kohës së përpunimit të shtetasve në PKK deri në 45 sekonda;
- Përfundimi i harmonizimit të kuadrit ligjor MIK me standardet Schengen deri në vitin 2018.

J. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Objektivat Specifike

1. Konsolidimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në drejtim të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurave të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar:
 - 1.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet e rajonit, si me Kosovën, Serbinë, Bosnje – Hercegovinën dhe më vendet e tjera të Bashkimit Evropian dhe më gjerë;
 - 1.2 Ushtrimi i inspektimeve tematike dhe në bazë ankese në sistemin gjyqësor me qëllim monitorimin e respektimit të procedurave penale për realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, kryesisht të procedurave të ekstradimeve;
 - 1.3 Realizimi i trajnimeve me Shkollën e Magjistraturës dhe me organizata të tjera vendase dhe ndërvendase, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrative të institucioneve që mbulojnë çështjet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.
2. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere të zbatimit të ligjit nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të operacioneve të përbashkëta kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme
3. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e hetimeve të përbashkëta, duke u fokusuar veçanërisht dhe në ekzekutimin e urdhrave të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të lëshuara nga vendet e Bashkëpunimit Evropian e me gjerë.

Indikatorët

- Rritja çdo vit me 10 % e numrit të rasteve të hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare;
- Rritja e numrit të operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare me 5 % deri në vitin 2015 dhe 10 %, deri në vitin 2020, krahasuar me vitin 2012;
- Kryerja çdo vit e jo më pak se 30 operacioneve nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar;

K. Përmirësimi i kapaciteteve të Policisë Shkencore

Objektivat specifik:

1. Rritja e kapaciteteve në drejtim të ekzaminimeve me anë të ADN-së
 - 1.1..Realizimi i interpretimit statistikor të rezultateve të përfutuara me anë të ADN-së.
 - 1.2 Përfitimi i profileve të ADN-së nga mbetjet kockore.

2. Rritja e kapaciteteve përpunuese dhe ekzaminuese të provave dixhitale filmike
- 2.1 Implementimi i protokolleve të përmirësimit të cilësisë së pamjeve filmike ekzistuese, nëpërmjet implementimit të programeve dhe pajisjeve ekzaminuese;
- 2.2 Nxjerrja e karakteristikave identifikuese të personave apo objekteve nga pamjet filmike;
- 2.3 Realizimi i nxjerrjes së sekuencave kohore nga materiali filmik dhe bashkimi i tyre me qëllim paraqitjen prej OPGj-së para organit procedues apo gjykues të mekanizmit të ngjarjes.

Indikatorët:

- Rritja me 7%, treguesit e përdorimit të teknologjive ekzistuese në zbulimin dhe identifikimin e provave ligjore që fiksohen e mbledhen nga vendi i ngjarjes deri në vitin 2020;
- Sigurimi i minimumit të 200 profileve të personave që nuk kanë lidhje gjaku ndërmjet tyre deri në vitin 2020

L. Forcimi i efektivitetit të strukturave të luftës kundër krimit kibernetik

- Objektivat specifike:

1. Rritja e kapaciteteve administrative të strukturave të luftës kundër krimit kompjuterik;
- 1.1 Riorganizimi strukturor i strukturave qendrore dhe vendore;
- 1.2 Futja e pajisjeve moderne kompjuterike dhe programeve të avancuara;
2. Fuqizimi i kapaciteteve trajnuese të personelit;
- 2.1 Zhvillimi i trajnimeve për specialistët;
- 2.2 Rishikimi i përshkrimeve të punës;
- 2.3 Hartimi i procedurave standarde.

Indikatorët:

- Numri i hetimeve për mashtrimet kompjuterike dhe në internet do të rriten në 7% deri në vitin 2020
- Numri i hetimeve për abuzimin e të miturve në internet do të rritet me 2 % deri në vitin 2016
- Numri i provave dixhitale të sekuestruara në funksion të hetimit do të rriten me 5 % deri në vitin 2016



Kapitulli 4 Burimet financiare

Programi afatmesëm dhe afatgjatë për planifikimin strategjik, që është SKZHI, përcakton përparësitë dhe synimet strategjike për Hetimin e Krimeve deri në vitin 2020.

Çdo ministri ka përgatitur një plan afatmesëm dhe afatgjatë brenda një tavani shpenzimesh të përcaktuar. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve Korrik dhe Tetor. Gjithashtu, në identifikimin e nevojave për burime financiare, një vend të rëndësishëm do të zënë dhe projektet e huaja si dhe detyrimet e dala në kuadër të procesit integruar të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Tavanet buxhetore të alokuara përgjatë viteve 2013-2020 për institucionet, si vijon: Sistemi i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrisë Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Jashtme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, METE, SHISH.

Donatorët partnerë të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Brendshme dhe ministrive të linjës që trajtojnë çështjet e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit përmes zbatimit IPA, OSBE, ICITAP, KE etj., do të vazhdojnë të luajnë një rol kryesor në financimin e projekteve të nisura apo të planifikuara për t'u financuar.

Policia e Shtetit ka përgatitur një plan afat afatmesëm dhe afatgjatë brenda një tavani shpenzimesh të përcaktuara për nen programin Hetimi i Krimeve. Tavanet buxhetore të çdo viti të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve Korrik dhe Tetor.

Gjithashtu, në identifikimin e nevojave për burime financiare, një vend të rëndësishëm zënë dhe projektet e huaja si dhe detyrimet e dala në kuadër të procesit integruar të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Tavanet buxhetore të alokuara përgjatë viteve 2013-2020 për Hetimin e Krimeve është si më poshtë:

Strategjia për Hetimin e Krimeve sipas viteve të PBA-së 2013-2020 në mijë lekë.

Nr	Viti	Vlera
1	2013	1997510
2	2014	2154924
3	2015	2218501
4	2016	2315102
5	2017	2337660
6	2018	2535242
7	2019	2736612
8	2020	3049303
Totali		19,344,854

Fondet e alokuara ndër vite sipas produkteve dhe aktiviteteve për çdo objektiv (në mijë lekë)

7

Nr	Nënspektori	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	Shpenzime korrente (paga)	1997510	2154924	2218501	2315102	2337660	2535242	2736612	3049303
1	Kundër terrorizmit	117679	132664	210390	219590	239680	303900	354100	424250
2	Lendët narkotike	353248	407355	401461	417158	423800	425020	425512	444561
3	Trafiqe (qenie njerëzore, armët dhe prostitucion)	312209	382920	320026	412819	417404	427635	440428	445872
	Policia shkencore	225139	230859	273034	258500	261600	363259	368123	369843
4	Krimi Kompjuterik	31229	34352	37475	43652	45298	48725	49561	51239
5	Krimi Ekonomik	310432	313373	319837	316259	287245	285933	390036	392198
6	Mbrojtja e dëshmitarve	129950	129950	129950	129500	129600	130010	135600	183689
7	Përditësimi i informacionit kriminal dhe shpërblim informatorësh	517624	523451	526328	517624	533033	550760	573252	737651

Projektet e Strategjisë së Hetimit të Krimeve

- Ndërtim i ambienteve të reja të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve në shumën 76,220,000 lekë
- Blerje pajisje për Policinë Shkencore në shumën 3,524,000 leke
- Blerje pajisje për policinë kriminale për vitin 2016 në shumën 10,000,000 lekë; për vitin 2017 në shumën 10,000,000 lekë; për vitin 2018 në shumën 5,000,000 lekë; për vitin 2019 në shumën 10,000,000 lekë; për vitin 2020 në shumën 30,000,000 lekë.

⁷ Në zërin shpenzime korrente janë përllogaritur e kostuar, produktet dhe aktivitetet për çdo objektiv referuar PBA. Kështu që në shpenzimet korrente janë përfshirë paga, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe shpenzimet e tjera mallra dhe shërbime në funksion të çdo produkti.



Kapitulli 5 Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza

Monitorimi i saj behet në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit dhe Planit të saj të Veprimit, në funksion të të cilit është ngritur dhe funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit, të ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm dhe i kryesuar nga Kryeministri.

Në përbërje të Komitetit, me cilësinë e anëtarit, janë ministrat dhe titullarët e institucioneve, si më poshtë:

1. Ministri i Brendshëm
2. Ministri i Mbrojtjes
3. Ministri i Financave
4. Ministri i Drejtësisë
5. Ministri i Punëve të Jashtme
6. Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror
7. Prokurori i Përgjithshëm

Me Vendimin nr. 1, datë 05.02.2010, të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit" është miratuar Rregullorja "Për Funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit".

Në **Nenin 6** të kësaj rregulloreje është përcaktuar funksionimi i Sekretariatit Teknik Ndërinstitucional si dhe përbërja e tij. Në zbatim të Nenit 6, pika 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, është përcaktuar se Sekretariati Teknik Ndërinstitucional mbledhet çdo tre muaj. Në takimet marrin pjesë të gjithë anëtarët e këtij Sekretariati dhe diskutojnë mbi ecurinë e veprimtarive të Sekretariatit Teknik, detyrimet e secilit institucion lidhur me zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve të Strategjisë Ndërsektoriale dhe Planit të saj të Veprimit si dhe të zbatimit të Ligjit (Antimafia) nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

Sekretariati Teknik Ndërinstitucional mbledhet dhe zhvillon takimet nën drejtimin e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për hetimin e Krimeve me pjesëmarrësit nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Prokuroria për Krimet e Rënda;
- Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar, në SHISH;
- Shërbimit Informativ të Ushtrisë (Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes);
- Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale, në Ministrinë e Drejtësisë;
- Njësia Antitrafik në Ministrinë e Brendshme;

- Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme;
- Sektori për Hetimin e Aseteve Kriminale, në Departamentin për Hetimin e Krimeve.

Gjithashtu, i është sugjeruar Komitetit që të marrin pjesë në Sekretariatin Teknik dhe përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, meqenëse gama e problemeve i tejkalon kompetencat e Prokurorisë për Krimet e Rënda.

Në strategji është parashikuar që përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji ta ketë Ministria e Brendshme, e cila nëpërmjet Sekretarit Teknik:

- Të grumbullojë detyrat e veçanta të të gjithë institucioneve të tjera;
- Të marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

Sekretariati Teknik në vijimësi të takimeve të zhvilluara analizon situatën e përmbushjes së detyrimeve nga çdo institucion përgjegjës dhe informon rregullisht Kryetarin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit duke bërë dhe sugjerimet përkatëse.

Me hartimin e strategjisë së re ndërsektoriale 2013–2020, duhet të dalin aktet e reja normative që të përcaktojnë ndoshta zgjerimin e numrit të anëtarëve të Komitetit Teknik Ndërinstitucional dhe Sekretariatit të tij Teknik.

Monitorimi i këtyre rezultateve do të jetë i brendshëm dhe i jashtëm. Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë, duke u mbështetur të indikatorët e performancës si më poshtë:

Si indikatorë të brendshëm do të jenë:

- Shkatërrimi i grupeve kriminale të përfshira në këto aktivitete.
- Sekuestrimi i pasurive të rrjedhura nga këto aktivitete të paligjshme
- Arrestimi i i personave me precedentë kriminal
- Treguesit e tregut të paligjshëm të narkotikëve
- Minimizimi i korrupsionit dhe renditja e Shqipërisë në vendet që luftojnë me efektivitet korrupsionin
- Përdorimi i formave dhe mjeteve të veçanta të hetimit
- Paraqitja e një situatë të sigurt në vend e standarde të mira të rendit.

Si indikatorë të jashtëm do të jenë:

- Vlerësimet e publikut, qytetarëve dhe bizneseve të ndryshme nëpërmjet matjes së perceptimit të publikut duke përdorur pyetësorë, intervista dhe organizuar forume të hapura.
- Vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, në raporte periodike apo buletine.
- Vlerësimet e vendeve të rajonit për treguesit e minimizimit të krimit të organizuar në Shqipëri.



Te gjitha institucionet e tjera do të dërgojnë një raportim të plotë për masat e marra lidhur me implementimin e kësaj strategjie si dhe strategjive të tjera çdo fund 3 mujori në Ministrinë e Brendshme, duke shpjeguar dhe arritjet e realizuara nga implementimi i masave.

Çdo vit, pasi të jenë marrë kontributet nga institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e kësaj strategjie, Ministria e Brendshme, do të përpilojë një raport monitorimi të bazuar në rezultate në përputhje me Urdhrin 139 të Kryeministrit për "Zbatimin e Procesit të monitorimit të strategjive sektoriale e ndersektoriale". Në këtë raport do të pasqyrohet shkalla e arritjes së indikatorëve vit pas viti.

Qeveria do të marrë në analizë punën e institucioneve të përmendura në këtë strategji në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit çdo vit si dhe do të bëjë publike arritjet pas çdo faze të implementimit të objektivave e planeve të veprimit, si dhe pasqyrojë arritjet kundër krimit të organizuar.

VENDIM

Nr. 670, datë 7.8.2013

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DHOMËN KOMBËTARE TË AVOKATISË, TË PASURISË SË PALUAJTSHME, ME SIPËRFAQE 25 000 M², ME NR. 1/190, NË ZONËN KADASTRALE NR. 8210, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të pasurisë së paluajtshme, me sipërfaqe 25 000 (njëzet e pesë mijë) m², me nr. 1/190, në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është komponent i pronës nr. 64, me emërtim "Ish-fusha e aviacionit", sipas hartës bashkëlidhur. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë saktësimin e të dhënave hartografike dhe të kufijve të pasurisë së paluajtshme, që i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe më pas, menjëherë, të vijojë me procedurat e regjistrimit të ndryshimit të përgjegjësisë së administrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 699, datë 16.8.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE, NDËRMJET “ALBPETROL”
SHA DHE “PHOENIX PETROLEUM” SHA, PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMET E NAFTËS AMONICË, DRASHOVICË E
PEKISHT-MURRIZ, SI DHE VENDBURIMET E GAZIT PANAJA, FRAKULL, POVELÇË,
DIVJAKË, BALLAJ-KRYEVIDH DHE FINIQ-KRANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure, ndërmjet “Albpetrol” sh.a. dhe “PHOENIX Petroleum” sh.a., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, përkatësisht për:

- a) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Amonicë;
- b) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Drashovicë;
- c) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Pekisht-Murriz;
- ç) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Panaja;
- d) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Frakull;
- dh) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Povelçë;
- e) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Divjakë;
- ë) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Ballaj-Kryevidh;

Kryevidh;

- f) zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Finiq-Krane.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 26.8.2013
Doli nga shtypi më 26.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë